

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË MAMUSHË

PROJEKTET E MONITORUARA
“GJENERATORË DHE PAJISJE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E DYSHEMEVE -
PËR OBJEKTET KOMUNALE (ADMINISTRATË, ARSIM DHE SHËNDETËSI)”





Nëntor 2025

Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo. Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË MAMUSHË

PROJEKTET E MONITORUARA
“GJENERATORË DHE PAJISJE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E DYSHEMEVE -
PËR OBJEKTET KOMUNALE (ADMINISTRATË, ARSIM DHE SHËNDETËSI)”



DEMOS Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat. Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Suedeze dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë. Mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës Komunale si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar. Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët. Projekti i DEMOS ka mbështetur edhe ndërtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë qytetarët në vendimarrje duke përfshirë ekipet e Auditimit Social të cilat kanë mbikëqyrur implementimin e projekteve të cilat janë financuar nga Granti i Performancës.

BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë.

Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova në partneritet me Demokraci Plus është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e Auditimit Social në 16 projektet e përgjedhura në gjashtë komuna, Drenas, Lipjan, Istog, Dragash, Kaçanik dhe Mamushë.

Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. D+ tenton integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet e tyre, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie. D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

Mamuşa Emekçi Kadınlar Derneği është shoqatë e pavarur dhe jofitimprurëse, e themeluar në nëntor 2022 me përkrahje të UN Women dhe Institutit Yunus Emre, me qëllim të fuqizimit të grave në Komunën e Mamushës dhe të komunitetit turk. Shoqata synon të përmirësojë pozitën sociale, ekonomike dhe kulturore të grave përmes zhvillimit profesional, pjesëmarrjes aktive në jetën publike dhe rritjes së vetëdijes për të drejtat dhe barazinë gjinore.

Mamuşa Emekçi Kadınlar Derneği është e përkushtuar të krijojë mundësi të reja për gratë përmes organizimit të trajnimeve profesionale, aktiviteteve edukative dhe nismave sociale që nxisin vetëpunësimin dhe integrimin ekonomik të grave në komunitet. Shoqata bashkëpunon ngushtë me institucionet lokale, organizata vendore dhe ndërkombëtare për të forcuar rolin e grave në vendimmarrje dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit. Përmes aktiviteteve të saj, Mamuşa Emekçi Kadınlar Derneği synon të jetë një shembull pozitiv i solidaritetit dhe angazhimit të grave punëtore, duke ndërtuar një shoqëri më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.



PËRMBAJTJA

7	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
8	GJETJET E PËRGJITHSHME
8	Gjetjet në projektin “Gjeneratorë dhe pajisje elektrike për pastrimin e dysHEMEVE për objektet komunale (administratë, arsim, shëndetësi)”
9	AMBIENTI KU ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL
9	Procesi i konsultimeve me qytetarët
10	Projekti adreson një nevojë të përsëritur të komunitetit për furnizim të qëndrueshëm me energji
11	GJETJET NË PROJEKTIN “GJENERATORË DHE PAJISJE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E DYSHEMEVE PËR OBJEKTET KOMUNALE (ADMINSTRATË, ARSIM DHE SHËNDETËSI)
13	Përdorimi dhe nevojat praktike për gjeneratorët
13	Gjendja jo e mirë e dysHEMEVE të institucioneve
13	Përfshirja e komunitetit
14	REKOMANDIME
15	METODOLOGJIA
16	Kush e themelon ekipin e Auditimit Social?
16	Si u grumbulluan të dhënat?
16	Validimi i të dhënave
17	Përbërja e ekipit
17	Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social
18	EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË MAMUSHË
19	LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË MAMUSHËS
20	LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E MAMUSHËS

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me metodologjinë e paracaktuar, D+ dhe Mamuša Emekçi Kadınlar Derneği lehtësuan procesin e themelimit të ekipit të “Auditimit Social” në Komunën e Mamushës. Brenda tre muajsh, ekipi u angazhua për të analizuar dhe mbikëqyrur projektin, “Gjeneratorë dhe pajisje elektrike për pastrimin e dysHEMEVE - për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)”, vlera e të cilit është 52,333.66 euro.

Ekipi i Auditimit Social monitoroi punën në terren, analizoi specifikat e tenderit dhe zhvilloi konsultime të përbashkëta me komunën për evidentimin e gjetjeve të përgjithshme dhe specifike të projektit. Bazuar në këto gjetje, u përgatitën rekomandime konkrete për komunën për përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe monitorimit të projekteve publike.

Komuna e Mamushës është një nga komunat përfituese të Grantit të Performancës Komunale. Për të rritur cilësinë e projekteve të financuara nga ky grant, një ekip aktivistësh të shoqërisë civile nga Mamusha, i mbështetur nga programi DEMOS, nisi në gusht 2025 nismën e angazhimit qytetar në mbikëqyrjen e implementimit të projekteve publike.

Auditimi Social në Kosovë ka filluar të aplikohet nga DEMOS dhe organizatat e shoqërisë civile që nga viti 2022 dhe është zhvilluar më tej gjatë viteve 2023-2025. Me mbështetjen e projektit DEMOS dhe MAPL-së janë themeluar 35 grupe me më shumë se 700 qytetarë aktivë. Me mbi 700 anëtarë të përfshirë ndër vite, ekipet e Auditimit Social kanë ofruar mbi 200 rekomandime konkrete për përmirësimin e qeverisjes lokale dhe rritjen e transparencës institucionale.

Gjatë vitit 2025, BIRN dhe D+ së bashku me gjashtë organizata lokale – HANDIKOS Istog, HANDIKOS Kaçanik, HANDIKOS Drenas, OJQ Avoko, YAHR dhe MAMUŠA EMEKÇI KADINLAR DERNEĞİ me mbështetjen e DEMOS, themeluan gjashtë ekipe të Auditimit Social në komunat Dragash, Drenas, Lipjan, Mamushë, Kaçanik dhe Istog. Këto ekipe mbikëqyrën 16 projekte të komunave përfituese dhe u aftësuan përmes trajnimeve të specializuara në bazat e Auditimit Social, menaxhimit financiar dhe komunikimit strategjik.

Në Mamushë, pas hulumtimit dhe konsultimeve me komunitetin, mbi 15 qytetarë u përzgjedhën për t’u bërë pjesë e ekipit të Auditimit Social, të cilët fillimisht u trajnuan rreth procesit të Auditimit Social. Trajnimet përfshinë ligjërime dhe praktikë në terren, duke përfshirë vendosjen e kontakteve me komunën, analizimin e dokumenteve dhe verifikimin e fakteve. Gjatë këtij procesi u kryen vizita në terren dhe takime zyrtare mes komunës dhe ekipit të Auditimit Social. Ekipi hartoi rekomandime konkrete, të cilat u ndanë me komunën dhe për të cilat Komuna e Mamushës u zotua t’i zbatojë.

Ky raport nuk përfaqëson auditim financiar ose ligjor të kryer nga auditorë të licencuar sipas Ligjit për auditim, por një proces vullnetar të monitorimit qytetar të zbatimit të projekteve komunale në kuadër të programit DEMOS.

Ky proces tregon rëndësinë e angazhimit qytetar në rritjen e transparencës, përmirësimin e menaxhimit të projekteve publike dhe fuqizimin e organizatave lokale në qeverisjen komunale.

GJETJET E PËRGJITHSHME



Gjatë vitit 2025 nuk ka pasur fare pjesëmarrje qytetare në dëgjimet publike të organizuara nga Komuna e Mamushës.



Mungesa e pjesëmarrjes reflekton një trend të vazhdueshëm, për shkak të karakterit rural e bujqësor të komunës dhe praktikës së adresimit të kërkesave përmes kontakteve të drejtpërdrejta me zyrtarët komunalë.



Projekti është me rëndësi të madhe për komunitetin.



Komuna ka mbajtur takime të veçanta me përfituesit për prezantimin e projektit.



Tenderi është anuluar pas vlerësimit të komisionit dhe pastaj është rishpallur.

Gjetjet në projektin “Gjeneratorë dhe pajisje elektrike për pastrimin e dyshemeve për objektet komunale (administratë, arsim, shëndetësi)”



Tenderi është anuluar pas vlerësimit të komisionit



Përdorimi dhe nevojat praktike për gjeneratorët



Gjendja jo e mirë e dyshemeve të insitucioneve



Përfshirja e komunitetit



ÇKA DUHET TË DIJË NJË EKIP I AUDITIMIT SOCIAL?

Ekipet e Auditimit Social nuk nevojitet të jenë skajshmërisht profesionale. Ekipet kanë nevojë për vullnet dhe guxim qytetar; si dhe, rekomandohet të kenë njohuritë bazike, në:

- Funksionimin e Komunës;
- Qasjen në dokumente publike;
- Procesin e konsultimit me publikun - sidomos gjatë planifikimit të buxhetit dhe investimeve në Komunë;
- Procesin e prokurimit publik.

AMBIENTI KU ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Komuna e Mamushës është komuna më e vogël në Kosovë me 5,596 banorë¹, me një buxhet modest prej 2,871418.50 euro², duke përfshirë grantin qeveritar, të hyrat vetanake, bartja e të hyrave vetanake, grantet e përcaktuara të donatorëve të pranuar deri më 30.10.2025 dhe mbështetja përmes Grantit të Performancës kanë rëndësi të veçantë për sigurimin e shërbimeve bazike për qytetarët.

Projekti i monitoruar lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e kushteve të punës në administratë, arsim dhe shëndetësi, duke siguruar furnizim alternativ me energji dhe mjete moderne për pastrimin e hapësirave publike.



Procesi i konsultimeve me qytetarët

Për qytetarët e Komunës së Mamushës, komuna përfaqëson institucionin kryesor ku ata drejtohen për të paraqitur shqetësimet dhe për të kërkuar zgjidhjen e nevojave të tyre komunitare. Roli i komunës në planifikimin dhe zhvillimin lokal reflektohet përmes organizimit të takimeve dhe konsultimeve publike, të cilat synojnë përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Me qëllim të vlerësimit të funksionimit dhe efektivitetit të këtyre proceseve, ekipi i Auditimit Social ka analizuar dokumentacionin e konsultimeve publike të mbajtura në Komunën e Mamushës gjatë vitit 2025.

Gjatë këtij viti, Komuna e Mamushës ka ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për organizimin e dëgjimeve publike lidhur me procesin e hartimit të buxhetit komunal. Janë dërguar ftesa publike për qytetarët, janë bërë njoftime përmes rrjeteve sociale, janë vendosur afishe në hapësira publike dhe janë kontaktuar drejtpërdrejt grupe të interesit.³

Megjithatë, sipas të dhënave zyrtare të komunës të dërguara pas kërkesës për qasje në dokumente publike, gjatë gjithë vitit 2025 nuk është evidentuar asnjë pjesëmarrje e qytetarëve në dëgjimet publike të organizuara. Për rrjedhojë, procesverbalet dhe listat e pjesëmarrësve kanë mbetur bosh, duke reflektuar mungesën e angazhimit qytetar në këtë proces të rëndësishëm të vendimmarrjes buxhetore.

Sipas sqarimeve nga zyrtarët komunalë, kjo situatë nuk paraqet një rast të izoluar, por një trend të përsëritur ndër vite. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të komunës për të nxitur pjesëmarrjen, interesi qytetar ka mbetur i ulët.

Arsyet kryesore të identifikuara lidhen me:

- karakterin rural dhe bujqësor të komunës, ku gjatë periudhës kur zakonisht mbahen dëgjimet buxhetore, shumica e qytetarëve janë të angazhuar me punë sezonale;

¹ Popullsia në rajone dhe qytete, Agjencia e Statistikave të Kosovës [Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel të komunave, 2017 - 2024](#). (qasur për herë të fundit me 03.10.2025)

² Plani i buxhetit të Komunës së Mamushës 2023 – 2025 <https://mamushe.rks-gov.net/shpenzimet/> (qasur për herë të fundit me 11.10.2025)

³ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Informimi publik dhe konsultimi, neni 68 <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

- mungesën e praktikës së pjesëmarrjes kolektive në takime publike;
- faktin që qytetarët në Mamushë kanë qasje të drejtpërdrejtë te Kryetari dhe zyrtarët komunalë, përmes të cilëve shpesh i adresojnë kërkesat individualisht, jashtë formateve zyrtare të dëgjimeve publike.

Ky realitet tregon se, ndonëse mekanizmat formalë të pjesëmarrjes ekzistojnë, nuk janë shfrytëzuar nga qytetarët, gjë që e kufizon dimensionin përfaqësues dhe konsultativ të procesit buxhetor. Për të përmirësuar këtë situatë, nevojitet që Komuna e Mamushës të zhvillojë forma më të përshtatshme të përfshirjes, duke i përshtatur periudhat, mënyrat dhe format e komunikimit me qytetarët sipas kontekstit lokal.



Projekti adreson një nevojë të përsëritur të komunitetit për furnizim të qëndrueshëm me energji

Projekti në Komunën e Mamushës gjatë këtij viti, përmes Grantit të Performancës Komunale, është rezultat i një nevoje të qartë të shprehur nga komuniteti dhe institucionet lokale. Mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike ka krijuar vështirësi në funksionimin e përditshëm të administratës, shkollave dhe qendrës së shëndetit, duke ndikuar drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve

bazë për qytetarët. Po ashtu, institucionet kanë hasur vështirësi në mirëmbajtjen e kushteve të duhura higjienike për shkak të mungesës së pajisjeve efikase për pastrim. Përmes këtij projekti është synuar të sigurohen kushte më të përshtatshme pune, të rritet cilësia e shërbimeve publike dhe të garantohet një mjedis më i pastër e më funksional për komunitetin e Mamushës.



GJETJET NË PROJEKTIN

“GJENERATORË DHE PAJISJE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E DYSHEMEVE PËR OBJEKTET KOMUNALE (ADMINSTRATË, ARSIM DHE SHËNDETËSI)

Projekti për sigurimin e gjeneratorëve dhe pajisjeve elektrike për pastrimin e dysHEMEVE u vlerësua si shumë i rëndësishëm për komunitetin e Mamushës, pasi adreson disa nga sfidat më të shpeshta me të cilat përballen institucionet lokale. Ndërprerjet e energjisë elektrike kanë ndikuar drejtpërdrejt në procesin mësimor, në funksionimin e administratës komunale dhe në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, duke krijuar nevojë urgjente për burime alternative të furnizimit me energji. Në anën tjetër, mungesa e pajisjeve moderne për pastrim ka ndikuar në cilësinë e kushteve higjienike në institucione, veçanërisht në QKMF dhe shkolla, ku qarkullimi i qytetarëve dhe nxënësve është i lartë.

Për këtë arsye, projekti është parë jo vetëm si investim në infrastrukturë, por si një hap drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike, rritjes së efikasitetit të punës dhe sigurimit të një mjedisi më të pastër e më të shëndetshëm për komunitetin.

Në këtë aktivitet të prokurimit, i cili kishte të bënte me furnizimin me gjeneratorë dhe pajisje tjera elektrike me vlerë të parashikuar të kontratës 52,333.66 euro, Komuna e Mamushës, përdori procedurën e hapur ku mund të dorëzonin oferta të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Ky tender u publikua në platformën elektronike e-prokurimi me datën 5 shtator 2025, ndërkohë afati i fundit për dorëzimin e ofertave u caktua 25 shtator 2025, kohë e mjaftueshme për përgatitjen e ofertave.

Nga analizimi i Dosjes së Tenderit, grupi i Auditimit Social nuk evidentoi ndonjë kërkesë specifike diskriminuese apo favorizuese si p.sh përmendja e ndonjë marke apo brendi të caktuar. Pas publikimit të Njoftimit për vendimin e autoritetit kontraktues⁴ grupi i AS, ka konstatuar se ky aktivitet i prokurimit është anuluar, pasi Komisioni i vlerësimit brenda komunës ka vendosur që asnjëra nga tri ofertuat e dorëzuara nuk kishte qenë e përgjegjshme.

Nr.	Emri dhe adresa e operatorit ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertës
1.	Eno, Croup SH.P.K., Dëshmorët e Ponoshecit, 10000, PRISHTINË	43,850.00 €
2.	N.T. “Day Star “, Selajdin Berisha, 20000, Prizren	46,500.00 €
3.	ROA Consulting SH.P.K., Sallabajë - Lluzhan, p.n, 11050, Podujevë	41,500.00 €

⁴ Vendimi është publikuar në faqen elektronike e-prokurimi, me datën 8 tetor, 2025.

Pas analizimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, grupi i Auditimit Social ka konstatuar se Komisioni Vlerësues kishte eliminuar tre operatorë ekonomikë për shkak të mospërputhjeve teknike me specifikat e kërkuara në dosjen e tenderit:

- **Operatori 1** është eliminuar pasi dimensionet e gjeneratorëve të ofruar (për të dy gjeneratorët) nuk përputheshin me dimensionet minimale të kërkuara në Aneksin nr. 1 të dosjes së tenderit. Edhe pas kërkesës për sqarim, operatori kishte deklaruar se dimensionet nuk ishin thelbësore, por komisioni ka theksuar se ato ishin specifika minimale të detyrueshme.
- **Operatori 2** është përjashtuar për të njëjtën arsye – mospërputhje të dimensioneve të kanopisë së gjeneratorëve me kërkesat minimale të Autoritetit Kontraktues. Edhe pse operatori ka argumentuar se dimensionet nuk ndikojnë në cilësi, komisioni ka konstatuar se çdo devijim nga specifikat minimale e bën ofertën të papërgjegjshme.
- **Operatori 3** gjithashtu nuk ka përmbushur kërkesat për dimensionet e kanopisë së gjeneratorëve. Diferencat në parametra, edhe pse të vogla sipas operatorit, janë konsideruar mospërputhje thelbësore, duke e bërë ofertën të papërgjegjshme.

Pas anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, ekipi i Auditimit Social është takuar me Zyrën e Prokurimit të Komunës së Mamushës për të adresuar shqetësimet dhe për të diskutuar hapat e mëtejshëm në lidhje me procesin. Gjatë këtij takimi, ekipi u informua

se arsyeja kryesore e anulimit kishte qenë mospërmbushja e një specifike teknike nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, konkretisht dimensionet e gjeneratorëve të ofertuar, të cilat nuk përputheshin me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Gjatë takimit, ekipi i Auditimit Social rekomandoi që specifikat teknike të thjeshtohen dhe të jenë më gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të shmanget rreziku i anulimit të përsëritur të procesit të prokurimit. Përfaqësuesit e komunës njoftuan ekipin se kjo vërejtje është marrë parasysh dhe se dosja e tenderit tashmë është rishikuar në këtë drejtim.

Për të siguruar një proces më efektiv dhe për të shmangur përsëritjen e së njëjtës situatë, Komuna ka rishpallur tenderin me afat të shkurtuar⁵ duke bërë një ndryshim të vogël, por të rëndësishëm në dosjen e tenderit – largimin e specifikës lidhur me dimensionet e kanopisë së gjeneratorëve. Sipas përfaqësuesve të Zyrës së Prokurimit, ky ndryshim është bërë pasi është vlerësuar se ekzistojnë gjeneratorë që plotësojnë të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale, edhe pa pasur nevojë për kufizim në dimensione.

Gjithashtu, me qëllim të rritjes së transparencës dhe përfshirjes qytetare në proceset e prokurimit publik, Komuna ka ftuar ekipin e Auditimit Social që të marrë pjesë në momentin e pranimin teknik të pajisjeve, sapo ato të dorëzohen nga operatori fitues. Kjo ftesë u vlerësua si një praktikë pozitive që kontribuon në rritjen e besimit dhe llogaridhënies ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve.



⁵ Tenderi është rishpallur në faqen elektronike e-prokurimi më 17 tetor, me afat për dorëzimin e ofertave deri më 27 tetor 2025.



Përdorimi dhe nevojat praktike për gjeneratorët

Ekipi i Auditimit Social vlerësuan si të domosdoshëm gjeneratorët për funksionimin e institucioneve gjatë ndërprerjeve të energjisë, sidomos në periudhat kritike si orët mësimore, punët administrative dhe shërbimet shëndetësore. Qytetarët vunë në dukje se prioritet duhet të kenë hapësirat jetike: klasat kryesore (ku procesi mësimor zhvillohet me tabela digjitale për shkak të

mungesës së librave në gjuhën turke (QKMF-ja që punon 24/7 dhe zyrat komunale me funksione të pandërprera, si dhe paisjet që duhet domosdoshmërisht të mbulohen nga gjeneratorët janë frigoriferët mjekësorë, serverët IT dhe laboratorët. Qytetarët raportuan ndërprerje të shpreshta në të kaluarën, të cilat kanë shkaktuar pengesë procese mësimore dhe vështirësi në QKMF.



Gjendja jo e mirë e dyshemeve të institucioneve

Gjatë diskutimeve dhe vizitës në terren, u theksua se dyshemetë në institucionet publike, veçanërisht në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në shkollat e komunës, ndodhen në gjendje jo të mirë për shkak të mungesës së pajisjeve adekuate për pastrim dhe mirëmbajtje të rregullt. Pjesëmarrësit e takimeve theksuan se pastrimi është kryer kryesisht me mjete manuale, gjë që nuk ka garantuar pastërti të mjaftueshme, sidomos në

hapësirat me qarkullim të lartë si korridoret, sallat e pritjes dhe klasat. Në këtë drejtim, sigurimi i dhjetë pajisjeve elektrike për pastrimin e dyshemeve u vlerësua si një hap i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve higjienike, por u theksua se ato duhet të shpërndahen proporcionalisht sipas madhësisë dhe nevojave të institucioneve, me fokus të veçantë tek QKMF.



Përfshirja e komunitetit

Ekipi i Auditimit Social theksuan rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies gjatë gjithë procesit të zbatimit të projektit. U konfirmua se institucionet përfituese – Komuna, Shkolla dhe QKMF – janë konsultuar paraprakisht në fazën e identifikimit të nevojave, çka ka ndihmuar në përcaktimin e pajisjeve e nevojshme. Megjithatë, u vlerësua se monitorimi i procesit të prokurimit dhe pranimin të pajisjeve duhet të jetë më i rreptë, për të siguruar që ato të dorëzohen sipas standardeve dhe kërkesave teknike të përcaktuara.

Gjithashtu, u theksua domosdoshmëria e përfshirjes së komunitetit lokal në fazat e monitorimit të funksionimit të gjeneratorëve dhe pajisjeve, si mënyrë për të rritur transparencën institucionale dhe besimin qytetar në menaxhimin e fondeve publike.

REKOMANDIME


Ekipi i Auditimit Social në fund të projektit ka analizuar punën dhe ka arritur në disa përfundime.

Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje



- Komuna e Mamushës të ndër marrë hapa konkretë për nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në dëgjimet publike, duke përshtatur kohën dhe mënyrën e organizimit sipas karakteristikave lokale.
- Të promovohet dhe të fillojë zbatimi i buxhetimit me pjesëmarrje, si mekanizëm praktik për përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve komunale.
- Komuna të vazhdojë bashkëpunimin me qytetarët dhe grupet e interesit për të siguruar transparencë dhe për të rritur besimin e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.
- Të forcohet komunikimi publik dhe informimi i vazhdueshëm mbi përfitimet e pjesëmarrjes qytetare në planifikimin buxhetor dhe zhvillimin e projekteve komunale.

Rekomandimet për projektin e gjeneratorëve dhe paisjeve elektrike për pastrimin e dyshemeve - për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)



- Të vazhdohet me zbatimin e projektit duke siguruar që specifikat teknike të jenë të qarta, por jo kufizuese, në mënyrë që të shmangen vonesat apo anulimet e procedurave të prokurimit.
- Ekipi i Auditimit Social të përfshihet në procesin e pranimit teknik të pajisjeve, për të garantuar monitorim të pavarur dhe transparent.
- Komuna të sigurojë shpërndarje të drejtë të pajisjeve për pastrim, duke marrë parasysh madhësinë, frekuencën dhe ngarkesën e institucioneve përfituese.
- Të përgatitet plan i mirëmbajtjes dhe ruajtjes së pajisjeve, me përgjegjësi të qarta për institucionet përfituese, në mënyrë që të shmangen dëmtimet dhe shpenzimet shtesë.
- Të përfshihet komuniteti lokal në procesin e monitorimit dhe raportimit për funksionimin e gjeneratorëve dhe pajisjeve, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien publike.
- Ekipi i Auditimit Social poashtu rekomandoi që, në rast se mbeten mjete financiare nga fondet e parapara për blerjen e gjeneratorëve dhe pajisjeve të pastrimit, të shqyrtohet mundësia e sigurimit të një makine rrobalarëse për QKMF-në, pasi ajo është e domosdoshme për plotësimin e nevojave të këtij institucioni.

METODOLOGJIA

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me komunitetin. Në muajin korrik, DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në standarde

të paracaktuara përzgjedhi 16 projekte në 6 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social. Në kuadër të procesit të Auditimit Social u përfshinë 16 projekte në gjashtë komuna.

Emri i projektit	Komuna	Vlera	Faza e projektit në nisjen e auditimit
Gjenerator dhe pajisje elektrike për pastrimin e dyshemeve-për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)	Mamushë	52,333.66 €	Tenderim
Asfaltimi i Rrugës Llapushnik-Berishë-Faza e dytë	Drenas	497,724.00 €	Implementim
Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-Faza e dytë	Drenas	299,652.50 €	Implementim
Rehabilitimi rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc-Vuçak	Drenas	700,000.00 €	Tenderim
Instalimi i paneleve solare në kulmin e objekti të Komunës	Drenas	17,812.32 €	Tenderim
Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Lokacionet - Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	Kaçanik	241,111.11 €	Implementim
Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj	Kaçanik	260,885.45 €	Implementim
Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad	Dragash	80,299.82 €	implementim
Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës	Dragash	101,994.69 €	Implementim
Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash	Dragash	135,329.28 €	Implementim
Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)	Dragash	122,219.00 €	Tenderim

Ndërtimi i Shtratit të Lumit Istog dhe Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë	Istog	Vlera e parashikuar e kontratës është 7,498,356 € (Shtrati i lumit) 301,155 € (rrugët)	Tenderim Implementim
Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)	Lipjan	59,925.88 €	Implementim
Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir	Lipjan	121,555.55 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi	Lipjan	267,381.95 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturovc dhe Ribar i Madh	Lipjan	266,715.00 €	Implementim

Kush e themelon ekipin e Auditimit Social?

Ekipet e Auditimit Social janë të pavarura nga institucionet dhe mund të themelohen nga përfaqësues të komunitetit por edhe nga

grupe të tjera. Ekipet funksionojnë të pavarura nga qeverisja dhe nuk nevojitet miratim nga institucionet publike për themelimin e tyre.

Si u grumbulluan të dhënat?

Për përpilimin e këtij raporti ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.

Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, ekipi hartoi një listë me pyetje për projektet dhe kërkoj informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizoi dokumentet e pranuar nga Komuna. Për të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Mamushës.

Të dhënat në raport janë grumbulluar 14 anëtarët e ekipit të Auditimit Social dhe raporti është hartuar OJQ Mamuşa Emekçi Kadınlar Derneği, me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të D+. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Mamushës.


Validimi i të dhënave

Ekipi i Auditimit Social në Mamushë ka punuar në identifikimin e problemeve në projektin e implementuar në këtë komunë për të shkruar raportin. Në takimet e mbajtura ekipi u dakordua për gjetjet e përgjithshme rreth komunës dhe për gjetjet specifike të projektit.

Ekipi u dakordua edhe për rekomandimet e paraqitura në këtë raport. Pas strukturimit të gjetjeve ekipi është takuar me kryetarin e komunës dhe ka kërkuar komente nga komuna për gjetjet në raport. Para publikimit komuna ka pranuar raportin për komente eventuale.

Përbërja e ekipit

Përbërja e ekipit: **14 anëtarë.**



Drejtor Shkolle; Shef i QKMF; Elektricitist; Kontabilist; Staf mirëmbajtës të tri institucioneve; Motër Medicinale; Pensionist etj.

Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social

Shtator 2025	<ul style="list-style-type: none">● Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën e Mamushës● Publikimi i materialeve promovuese në rrjetet sociale● Trajnimi për OJQ-të lokale, partnere të projektit● Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit● Përgatitja e listës me profilet e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social nga OJQ Mamuša Emekçi Kadınlar Derneği● Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social● Dërgimi i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën e Mamushës● Trajnimi i ekipit të Auditimit Social● Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber● Pranimi i përgjigjeve dhe dokumenteve të kërkuara nga Komuna e Mamushës● Trajnimi, diskutimi dhe analizimi i dokumenteve të pranuar nga komuna● Vizita në terren e ekipit të Auditimit Social në projektet për monitorim● Takimi i ekipit me Menaxherët e Kontratave● Vizita e radhës në teren e ekipit të Auditimit Social
Tetor 2025	<ul style="list-style-type: none">● Takimi i ekipit të Auditimit Social për analizimin e të gjitha dokumenteve të pranuar nga Komuna e Mamushës● Vizita në teren nga ekipi i Auditimit Social● Takimi i ekipit për dakordimin e gjetjeve dhe rekomandimeve finale në draftimin e raportit● Vendosja e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit● Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social



EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË MAMUSHË

Nr.	Emri / Mbiemri	Profesioni / Funkzioni
1	Sevgi Mazrek	Motër Medicinale në QKMF
2	Avdi Mazrek	Elektricitist
3	Abdullah Mazrek	Kontabilist
4	Mirat Morina	Shef në QKMF
5	Faridin Morina	Staf i mirëmbajtjes në QKMF
6	Türkan Mazrek	Staf i mirëmbajtjes në Kuvendin Komunal
7	Rifat Krasniç	Drejtor i Shkollës së Mesme "Ataturk"
8	Hayridin Morina	Staf i mirëmbajtjes në Shkollën e Mesme "Ataturk"
9	Erol Morina	Drejtor në Shkollën Filllore "Anadolu"
10	Adem Morina	Staf i mirëmbajtjes në Shkollën Filllore "Anadolu"
11	Bayram Mazrek	Staf i mirëmbajtjes në Shkollën Filllore "Anadolu"
12	Türan Kacanik	Qytetare
13	Esat Mazrek	Qytetar
14	Adil Mazrek	Qytetar

LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË MAMUSHËS



Komuna e Mamushës, për herë të parë, është përfshirë në procesin e Auditimit Social si pjesë e përpjekjeve tona të vazhdueshme për të avancuar transparencën, llogaridhënien dhe bashkëpunimin me qytetarët tanë. Ky proces ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për të dëgjuar zërin e komunitetit, për të identifikuar fushat ku nevojiten përmirësime, si dhe për të forcuar marrëdhënien ndërmjet administratës lokale dhe qytetarëve.

Auditimi Social për Komunën tonë paraqet një hap të rëndësishëm drejt qeverisjes më të hapur dhe përfshirëse. Përmes këtij raporti, ne synojmë jo vetëm të bëjmë më të dukshme punën institucionale, por edhe të garantojmë se vendimmarrja dhe planifikimi komunal zhvillohen mbi bazën e nevojave reale të qytetarëve.

Përkushtimi ynë për transparencë dhe llogaridhënie do të mbetet i vazhdueshëm. Rezultatet dhe rekomandimet që dalin nga ky proces do të shfrytëzohen si udhërrëfyes për forcimin e shërbimeve publike, menaxhimin e duhur të burimeve dhe fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare.

Komuna e Mamushës shpreh falënderim për të gjithë qytetarët dhe organizatat partnere që kontribuan në realizimin e Auditimit Social 2025, duke dëshmuar se qeverisja e mirë ndërtohet përmes dialogut të hapur dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

*Me respekt,
Abdülhadi Krasniç
Kryetar i Komunës së Mamushës*

LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E MAMUSHËS

Procesi i Auditimit Social për ne, si qytetarë të Komunës së Mamushës, ka qenë një përvojë e re dhe shumë domethënëse. Si hera e parë që komuna jonë përfshihet në këtë proces, ky angazhim na ka ndihmuar të kuptojmë më mirë rolin që mund të luajmë në mbikëqyrjen e projekteve publike dhe rëndësinë e përfshirjes qytetare në vendimmarrje.

Përmes bashkëpunimit me Demokraci Plus (D+) dhe Mamuşa Emekçi Kadınlar Derneği, kemi fituar njohuri të vlefshme për mënyrën se si mund të rritet transparencja dhe llogaridhënia në nivel lokal. Gjatë këtij procesi kemi identifikuar çështje që mund të përmirësohen dhe i kemi adresuar ato tek autoritetet komunale, me qëllim që të kontribuojmë në një qeverisje më efektive dhe bashkëpunuese.

Ne e shohim Auditimin Social si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe qytetarëve, dhe shpresojmë që ky proces të vazhdojë të zhvillohet edhe në të ardhmen si një praktikë e qëndrueshme dhe e hapur për të gjithë.





 Democracy
Plus
www.dplus.org